

**ADMINISTRIMI I MBETJEVE QARKU KORÇË
NJËSIA E PROKURIMIT**Maliq më: **28/05/2026****PROCES-VERBAL-Tipi i Kontratës – SHËRBIME**

“Shërbime furnizimi dhe depozitimi me material inert (dhe) , përfshirë nxjerrjen , transportimin dhe depozitimin e materialit në Landfill”

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim .
(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Në bazë të nenit **21**, pika **2**, të Ligjit nr.**162/2020** “Për prokurimin publik (i ndryshuar)”, dhe nenit **78**, pika **2** e të VKM nr. **285**, datë: **19/05/2021** “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar)”, autoriteti/enti kontraktor ”Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Objekt i kontratës :“ *Shërbime furnizimi dhe depozitimi me material inert (dhe) , përfshirë nxjerrjen , transportimin dhe depozitimin e materialit në Landfill”*

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës **10**,
- b.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës **3**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet **76, 82 dhe 83** të ligjit nr.**162/2020** “Për prokurimin publik (i ndryshuar)”, nenit **26**, të VKM nr. **285**, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik(i ndryshuar)”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Vetëdeklarimi sipas KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin **77, pika 1/a dhe 2**, të LPP(i ndryshuar), nenit **40, pika 5**, të VKM nr.**285**, datë: **19/05/2021** ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar)”



2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve **2023,2024,2025** ; ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **30%** e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin **77**, pika **3**, e LPP, si dhe nenin **43**, të VKM nr. **285**, datë **19/05/2021** "**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**(i ndryshuar)". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr.**9920** datë **19/05/2008** , " **Për Procedurat Tatimore** " neni **64** "**Deklarata Tatimore**" .

Kriteri i kërkuara në pikën 2.2.1 është vendosur me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës

2.2.2 . Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet **2024,2025** , të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. **10091** , datë: **05/03/2009** " **Për auditimin ligjor , organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar** (i ndryshuar) " , i ndryshuar , Kreu **V** , neni **41** , pika c : *shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar , të cilat zbatojnë për raportimin financiar standartet kombëtare të kontabilitetit , kur në mbyllje të periudhës kontabël për dy vite rradhazi tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtem:*

- i) totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh,
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh,
- iii) ka mesatarisht 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël .

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin **77**, pika **3**, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin **43**, pika **4**, të VKM nr **285** datë:**19/05/2021** "**Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik** (i ndryshuar) ". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës , konkretisht është bërë bazuar në nenin **29**, pika 1 e Ligjit Nr.**8438** datë: **28/12/1998** "**Për Tatimin mbi të Ardhurat** " , i ndryshuar , si dhe kërkesave të Ligjit nr.**25** të vitit **2018** "**Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare**" .

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8 të DST**. Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose



nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit **26**, të VKM nr. **285**, datë **19/05/2021** (i ndryshuar) , ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin **82**, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njërive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin **2025** sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar. sipas përcaktimeve në ligjin nr. **9632**, datë: **30/10/2006** **“Për sistemin e taksave vendore (i ndryshuar)”**, neni **5**, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit **26**, pika **6**, të VKM nr. **285**, datë **19/05/2021** (i ndryshuar) , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin **77**, pika **3**, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenit **43**, pika **4**, të VKM nr. **285**, datë: **19/05/2021** **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar)”**.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se **40%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, e vërtetuar me :

- Kontratën përkatëse

Dhe

- Vërtetimin përkatës nga Autoriteti Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuar, e firmosur nga të dy palët.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin **77** të Ligjit nr. **162**, datë **23/12/2020** **“Për prokurimin publik (i ndryshuar) ”** dhe nenit **40**, pika **4** (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin **55**, pika **4/b**), të VKM nr. **285**, datë: **19/05/2021** **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar)”**. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj



është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se **40%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë dokumentacionin e stafit teknik si më poshtë :

- **1 (një) Eskavatorist**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme.

Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme); ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **2 (dy) drejtues mjete** me kontratë pune të vlefshme.

Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme); ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të **77**, të ligjit nr. **162**, datë: **23/12/2020** “Për prokurimin publik (i ndryshuar)” dhe nenit **41**, pika **4/ b) dhe c)**, të VKM nr.**285**, datë: **19/05/2021** “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar)”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë staf për realizimin e shërbimit të mirembajtjes së impiantit për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit është vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike argumentojmë ky kriter për të patur në staf një inxhinier mekanik dhe 1 teknik impiantesh është caktuar në bazë të kompleksitetit dhe rëndësisë së madhe që ka objekti i prokurimit për Autoritetin Kontraktor. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërbërje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me



sukses të kontratës objekt prokurimi. Personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me mjete të posaçme :

- **1 (një) eskavator (minimumi 30 ton)** për nxjerrjen dhe lëvrimin e materialit
- **4 (katër) kamiona me kapacitet (minimumi 15 ton)** për transportimin e materialit.

Të vërtetuar me :

- Certifikatë Pronësie.
- Leje Qarkullimi e vlefshme.
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme.
- Polica Sigurimi e vlefshme.
- Certifikatë për transport mallrash, lëshuar nga Bashkia.
- Foto të mjeteve.

Kur mjeti është me qera duhet të paraqesë :

- Kontratë e qerasë e vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës.
- Leje Qarkullimi e vlefshme
- Polica Sigurimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Foto të mjeteve.
- Certifikatë për transport mallrash, lëshuar nga Bashkia.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

- a) për mjetet në pronësi : - aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) për mjetet me qera : - të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj. - aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe bazuar në nenin **77** pika **4** , e LPP(i ndryshuar), si dhe nenin **40** , pika **8** të VKM nr. **285** datë: **19/05/2021** "**Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik**(i ndryshuar)".

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike argumentojmë ky kriter për të patur mjetet e posaçme është caktuar në bazë të kompleksitetit dhe rëndësisë së madhe që ka objekti i prokurimit për Autoritetin Kontraktor. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar



se kanë qëndrueshmëri, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Mjetet e Nevojshme për zbatimin e kontratës janë përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.4. Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti- Operatori ekonomik duhet të paraqesë leje mjedisore të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi, të lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, proceset që lidhen me ushtrimin e aktivitetit, si dhe nevojën për garantimin e respektimit të standardeve ligjore dhe mjedisore gjatë realizimit të kontratës. Duke qenë se aktiviteti objekt prokurimi lidhet me ushtrimin e veprimtarive që kanë ndikim në mjedis dhe kërkojnë kontroll nga autoritetet kompetente, paraqitja e lejes mjedisore konsiderohet një element i domosdoshëm për të provuar se operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik (i ndryshuar)”, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë dokumente që vërtetojnë aftësinë profesionale dhe teknike për realizimin e kontratës, si dhe në nenin 40, pika 5, germa “a” të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar)”, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.” Kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore është në përpjesëtim të drejtë me objektin dhe përmasat e kontratës dhe nuk krijon kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen në procedurë, pasi ajo përbën një detyrim ligjor për subjektet që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti. Nëpërmjet kësaj kërkesë synohet të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet dhe autorizimet e nevojshme ligjore për realizimin e kontratës në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe administrimit të mbetjeve apo proceseve që lidhen me aktivitetin objekt prokurimi.

2.3.5. Operatori Ekonomik të paraqesë certifikata të vlefshme për sistemin e menaxhimit të cilësisë SSH EN – ISO 9001: 2015.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr.162 datë: 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik (i ndryshuar)” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë:19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar), neni 44 ku cilësohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose



organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 datë: 19/05/2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar)”, neni 44 ”Kërkesat e cilësisë” , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë: 03/09/2018 për “Hartimin e Kriereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime”. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimi i Materialeve:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Material Mbulimi “dhe”	Material Mbulimi “dhe”	2500 m ³	Landfilli Maliq	Sipas Nevojave të AK

Sipas zërave të preventivit sasia e dheut për transport është: **2500 m³**.

- **1m³ “dhe” =1.6 ton**

- **2500 m³ x 1.6ton/m³= 4000 ton**

- **4000 ton material mbulimi “dhe” do transportohen për 60 ditë**

- **4000 ton : 60 ditë = 67 ton/ditë**

Kamioni veteshkarkues me kapacitet mbajtës minimum: **15 ton**

- **67 ton : 15 ton = 4 rrugë në ditë**

Materialet e sipërpërmendura do të përdoren për realizimin e mbulimit ditor dhe periodik të mbetjeve, si dhe për stabilizimin e sipërfaqeve të depozitimit, në përputhje me praktikat më të mira të menaxhimit të landfillit.




Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Për realizimin e këtij procesi, propozohet fillimi i procedurave të prokurimit publik, ku operatori ekonomik që do të shpallet fitues duhet të përmbushë këto detyrime:

- a) Të ketë të përcaktuar nga autoriteti kontraktor zonën e nxjerrjes së materialit, në përputhje me kriteret mjedisore dhe ligjore;
- b) Të kryejë në mënyrë të plotë dhe me përgjegjësi nxjerrjen, përpunimin (nëse është e nevojshme), ngarkimin dhe transportimin e materialeve deri në venddepozitim (landfill);
- c) Të sigurojë që materiali i furnizuar të jetë në përputhje me specifikimet teknike, duke garantuar cilësi, pastërti nga mbetje të dëmshme dhe përshtatshmëri për përdorim si material mbulimi;
- d) Të respektojë të gjitha kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë dhe transportin e materialeve;
- e) Të realizojë furnizimin brenda afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që të mos krijohen ndërprerje në procesin e mbulimit të mbetjeve.

Vendi i përcaktuar për **nxjerrjen, lëvrimin, ngarkimin, transportimin** e materialit mbulues “**dhe**” do të jetë në Fshatin **Bregas-Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia MALIQ.**



1.3. Cilësia e materialit dhe kontrolli.

Kërkesat e përgjithshme:

- Materiali mbulues duhet të jetë **material inert natyror**, i përshtatshëm për përdorim në landfill, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe praktikat më të mira të menaxhimit të mbetjeve.

**Kërkesat teknike detyruese:**

- Materiali duhet të përmbushë **të gjitha kushtet e mëposhtme:**
 - a) Të jetë **i sigur (i përpunuar mekanikisht).**
 - b) Të jetë **i homogjen**, pa përzierje të pakontrolluara
 - c) Të mos përmbajë:
 - mbetje urbane
 - mbetje organike
 - plastika, metal, dru apo materiale të tjera të huaja
 - d) Të jetë **i pastër nga substanca të rrezikshme apo ndotëse**
 - e) Të mos ketë përmbajtje argjilore të tepërt që pengon drenazhimin
 - f) Të ketë **aftësi të mirë kompaktimi** për mbulim efektiv
- **Të jetë i përshtatshëm për:**
 - a) mbulim ditor
 - b) mbulim periodik
 - c) stabilizim të sipërfaqes së landfillit
- **Origjina dhe përpunimi i materialit:**
 - a) Materiali duhet të vijë nga **burime të autorizuara** - Vendi i përcaktuar për Fshati **Bregas-Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia MALIQ.**
 - b) Zona e nxjerrjes është e miratuar nga Autoriteti Kontraktor dhe nga Bashkia Maliq.
- **Kontraktuesi (në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi) detyrohet të kryejë:**
 - a) nxjerrjen
 - b) sitjen/përpunimin
 - c) transportin

Kontrasti dhe pranimi i materialit:

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë:

- a) Të kryejë **kontroll vizual dhe teknik në çdo ngarkesë**
- b) Të refuzojë menjëherë materialin nëse:
 - nuk është i sigur
 - përmban mbetje të huaja
 - nuk përmbush kriteret e mësipërme
- c) Të kërkojë:
 - analiza laboratorike
 - dokumentacion mbi origjinën e materialit

**Refuzimi dhe zëvendësimi:**

- Në rast mosdakordësie:
 - a) Materiali **refuzohet në vend**
 - b) Kontraktuesi detyrohet:
 - ta tërheqë menjëherë me shpenzimet e tij
 - ta zëvendësojë brenda **24–48 orëve**
- Penalitete për cilësi të dobët:
 - a) Në rast përsëritjeje ose shkeljeje:
 - Aplikohet penalitet deri në **10% të vlerës së kontratës**
 - b) Në raste të rënda:
 - **zgjidhje e menjëhershme e kontratës.**
 - konfiskim i garancisë së kontratës.

Përgjegjësia mjedisore:

Kontraktuesi mban përgjegjësi të plotë për:

- a) çdo ndotje të shkaktuar nga materiali.
- b) çdo shkelje të legjislacionit mjedisor.
- c) çdo dëm ndaj landfillit apo mjedisit përreth.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP(i ndryshuar). Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT**Roald Neziri****Frederik Hamzallari****Elio Begolli**